

POEZI TË SHKRUARA NGA NXËNËS TË SHKOLLËS FILLORE NË FSHATIN DOBËRQAN

17shkurti (Nr. 9)

Serbisë i ikën vëllezrit
Edhe kushërinjte e parë
Duan të rrinë me Kosoven
Që s'jane as soj'e as farë..

I la vetem Mali i Zi
Me shekuj në dashuri
Kërkojnë nga shqiptaret
Qe t'u bejne shoqeri..

Miqësine po ta doni
Beni mire te na uroni
Fjale te mira te na thoni
Ashtu siç e do gjitoni

Ato që s'i thoni ju
Do i thote bota mbare
Gjithë ata që na duan
Anë'e'mbanë shqipëtarë

Një urim në zemër kemi
Ta gezojmë pamvaresine
Nëse duam veten, vendin
Do jet fat per kombin tim

Ndershmëria e dashuria
Mos te zgjas vetem nje dite
Korrupsioni e harbutria
Mos sundoftë vit për vit

PAVARESIA E VENDIT TIM (Nr. 8)

Shtetë, flamurë, kushtetutë
Vendit tim iu bënë kurorë
Si një trëndafilë petalëkuqë
Që të gjithë ia kanë lakmi
Merr trofeun e Lirisë
Më 17 shkurt 2008

Si kurorë e një mbretëreshe
Ballin qelë porsi pranverë
Sikur zogu në liri
Erdhi ditë e Pavarësisë

E shejntë kjo ditë qoftë
17 shkurti I madhë SHQIPETARE
KOSOVE, qofshë e bekuar
Ne ty të qofshim falë

Se mbaj fshehtë dot gëzimin
Më shëndritë në fytyrë
Se mbajë fshehtë dot lotin
Më sheh në sy
Ndaj, smë ndal shka e as njeri

Të them "KOSOVE"
URIME PAVARESINE

Vendi im mori bekimin
Erdhi ditë e pavarësisë
Dëgjuan fushat edhe malet
Për trojet e ILIRISE
Edhe zogjtë bashkë me ne
Thurnin vargjet e lirisë
E dëshmorët e kombit
I përjetesua më përgjithmonë
Si YJE në flamurin e Pavarësisë

Ditë historike
Endërr shekullore
Në brendësi ndjenë gëzimin
E në shpirtë krenarinë
Tash qdo zemër shqipëtare
Ndjenë lumturinë

Ndihemi fatlumë
Në kohën që jetuam
Pavarësinë e vendit tim
Më në fund e gëzuam

Drejtësia triumfoi
E I dha fundë robërisë
K O S O V A
“SHTETI ME I RI NE BOTE”
Sot feston
“DITELINDJEN E PAVARESISE”

17shkurti (Nr. 7)

Kosovë vend i betejës
Kosovë vend i gjakëderdhjes
rrezja e lirisë mezi të pershkoj
errësira e tradhëtis për herë të dobësoi

Linde trima te lirisë
po edhe drita te njerëzis
linde nënat Kosovare
po edhe Shqiponjën simbol Shqiptare

çdo herë ke qenë e lavdëruar
me burrëri e trimëri
po edhe një të keqe të qiti
tradhëtari me tradhëti

E çdo herë ne luftuam
asnjëherë ne nuk pushuam
për t'ia arritur një qëllim
për Pavarësinë e vendit tim

Atë që ne e pritum
tani më na erdhi
qëllimin që e patëm
më në fund e kemi

E kemi dhe plot 3 vjet
tani po i mbush
e gjithë Kosova po lulëzon
si lulet që qelin në fushë

Rreth e rreth Kosovës
dëgjohe brohorimat
ne qdo qosh e cep
thonë:URIME PAVARESIA

çdo plak e i ri
buzëqesh pa masë
se tani e kemi atë
që kurr se kemi pas

Sa herë që të vi
stina me e ftohtë
me datën 17
ne ndihemi te ngrohtë

E njëri pas tjetrit
lidhemi zingjir
me valle e tupana
festojmë Pavarësinë

Shume shpejtë
zingjiri ndryshoi formën
shumë njerëz po afrohen
që ta luajnë horën

Me këngë e tupana
Kosova po feston
për ti treguar e gjithë botës
se jemi popull i EUROPE

17 SHKURTI 2008
u shënua në histori
se më Kosova s'është Serbi
por ajo tani është me Shqipëri

Meritë e kësaj
janë dëshmorët tanë
ata që për liri
jetën e tyre dhanë

I qoftë i lehtë dheu
gjithë dëshmorve t'kombit Shqiptar
që e dhanë jeten e tyre
për lirinë e popullit tanë

Pra ju mos e harroni
veq nje emër
PAVARESINE e kem ne zemer
Ngase e zëmë ne gojë gati perditë
E PER ARDHJE PRESIM NJE VIT.

"17Shkurti" (Nr. 6)

Pse shëndrritka sot kaq shum dielli ?
Pse jem gëzuar sot si zogj qielli ?

Kemi festë e kemi hare
Sot një shtet në botë ka le !

Sot tek ne shihet lumturia

Edhe n'djep është gëzuar fëmia

Me gjak atë e kemi larë
Pavarsia sot na ka ardhë

Gëzuar juve o shqiptar
Luftarë e mërgimtar

Lavdi për juve o dëshmitar
Ju i vutë shtetit kurorë.

“Vitet e Paharruara” (Nr. 5)

Me siguri e dini pse jeni tubu
Nje fest kombetare duhet me kujtu
Shfrytezoj rastin nga ju me kerku
1 minut heshtje per trimat qe ran ketu

Une jam femije asgje skam perjetu
Prindrit , Gjyshi, Mesuesi, Arsimtari me kan tregu
Edhe vet histori kam lexu
Per gjitha tmirat e t'kqiat qe ndodhen ketu
Historin askush nuk mundi ta ndryshoj
Sepse populli ate me gjak e shkroi

Kam lexu per “MARIGONEN” nje shqipe sokolesh
Vajza trime ishte baresh
Ajo mori petkun dhe disa penje ne dore
Qendisi flamurin qe u ngrit ne “Vlorë”

Kam lexu per trima patriot shqiptar
Kam lexu per plakun me emer Ismail Qemal
I cili flamurin e ngriti ne Vlorë
Shqiperin e shpalli shtet me zor

Kam lexu per lidhjen e prizerenit dhe shum histori
Kam lexu per trima ne Kosovë dhe ne Shqiperi
Ismajl Qmajli me shoket e tij
Me 28 Nentor 1912 ne Vlorë ka mbrri

Aty populli ishte tubu
Trimat shqiptar I ka perqafu
Trimi I mir me shok shum kshyri per rreth dhe u ul ne gjunj
Ra ne gjunj e e puth flamurin
Ne flamur u betua me kto fjalëqe ne ket tekst une po I citoj

“Rreth flamurit te bashkuar ,me nje deshir e nje qellim
Te gjith ati duke iu betuar , ta lidhim besen per shpetim
Prej lufte veq ai largohet , qe eshte I lindur tradhetar
Kush eshte burr nuk frigoget , po vdes po vdes si nje deshmor”

Pas betimit dy fjal plaku I shqiptoj
Merne ket flamur shperndane neper shtepi
Mos e fshihni me ua solla ne Shqiperi
Une solla flamurin por jo edhe lirin
Sepse lirin une e gjeta ketu

Dituri te mbjellim , ju lutem dituri te gjith te kemi
Ne serish do ju sjellim te mira nga Prizereni

Te gjith te gezuar filluan me festu
Ne nje od burrash atje jan bashku
Nje nene shtroi sofren Ismajlin e puthi ne ball
I rrodhen dy pika lot I tha gjiri te qoft hallall

O Ismajl erdhe si trim I Shqiperis
Dhe e zure vendin e Skenderbeut
U ngrit flamuri I liris
Sod nga burrat e atdheut

Me kete flamur ne duar
Me kta trima fuqi plot
Shqipetaret e bashkuar do te degjohen ne botë

Gjith rrotull qe jemi
Musliman e te Krishter
Me far e me fis qe kemi
Besnik te jemi te tërë

Para tyre ket dit shum endrruan
Nga qielli Skenderbeu
Ju ndimon duke qar
Lutet , e lutet te Zoti
Qe puna te ju shkoj mbarë

De Rade me Naim beun
Qe punuan me deshir
Dit e nat per atdheun
Por se pan te lirë

Nuk mbahen nga gezimi
Brenda ne varr te thell
Se su shkoj kot mundi
Dhe dituria qe kan mbjell

Vaso Pasha Shkodrani past ndjes
Lutet te zoti ne qiell
Shqiptarizmin ta kesh ne besë
Ta ndriqosh vendin si diell

Kete fest shqipetaret duhet kudo me e festu
Per fat te keq ne Kosovë nuk ishte keshtu
Sepse armiku shum gjera na mohoj
Deshi edhe historin te na shtremboj
Nuk mbeti gje tjeter vetem me u bashku
Identitet dhe shtet dhe ne me kerku
Levizja nisi me u tubu
Per liri te popullit duhet me luftu

Tahir Meha rrugen e Ismajl Qemajlit trasoj
Adem Jashari me pas e vazhdoj
Popullit shqipetar lirin tua dhuroj
Armikun nga kosova filloi ta deboj
Sepse te gjith te drajtat neve na mohoj

Shum trima te tjerë e dhan kushtrimin
Filloj populli me u bashku
Si rezultat I kesaj UCK-ja u formu
Ishin djem tan vellezer e baballar
I rroken armet dhe dolen ne mal

Krisi pushka dhe u dha kushtrimi

Nga diaspora shum popull mbrini
Ju bashkuan njerezve qe dolen ne mal
Armiku nga kto troje kohen e ka me dal

Ne Karadak filluan qetat me u formu
Ne drenic vllezerit luften kan fillu
Llapi , Malsia ,Dukagjini ne luft kan hy
Filluan luften ta bejn me shkji
Komandanti legjendar po hartonte plane
Mos ta lem armikun te sillej ksaj ane

Keshtu lufta jon perparoj
Populli lirin ne fund e fitoj
Ju tregoi armiqeve qe nuk kna vend ketu
Ju tregoi Princave , Carave, dhe Knezve se ketu nuk kna prespektiv
Kjo tok ilire duhet te jet e lirë
Shum mbreteri ketu kan deshtu
Nje fat te till edhe car llazari e ka perjetu
I cili car I ngrat dy her ne Kosovë pesoii disfatë
Per te paren her ne Gazimestan
E per her te dyt edhe ne Gjilan

Populli yne fitore meritoj tash I lirë
Pavaresin do ta festojë

Por ne nje gje sduhet te harrojm
Heronjet e popullit qe ne kto toka pushojn
Si Ismajl Qemajlin dhe shum te tjerë
Qe ne kete tekst I kam permbledh
Ju jemi mirenjohes dhe si harrojm kurr rezultat I tyre eshte lirija jonë
Shrytzoj Rastin me kete punim
Lirin e vendit tia uroj popullit tim
Kurse per heronjet gjdo rrespekt
Shpirti I tyre u shkoft ne gjenet

17 SHKURTI (Nr. 4)

Sot me mëngjes me mall u zgjova,
pse nuk kisha afër ata që i doja,
pse nuk munda të shkoja atje ku dua,
pse isha tretur në dhen të huaj!

E sa vdiqën e sa u plagosën,
sa herë KOSOVËN e prangosën,
por një nderë na dha fuqi,
se k'ti vendi i than SHQIPTARI!

U munduan të na shkelin,
të na vrasin, të na djegin,
por armikut i dolëm ball,
s'ka kush e vran këtë vatan!

Pushkë e top bashkë i kem ba,
thirrëm nanën SHQIPËRI,
u bëmë bashkë Plavë e Guci,
se kështu formojmë fuqi!

Thirrëm Bujanovc e Preshevë,
Qamëri e Medvegjë,
Manastir e Kumanovë,

i rrimë krah shtetit KOSOVË!

Me 17shkurt 2008,
shqiponja e zezë porsi shigjetë,
mbledhi shpejtë burrat e shqipës,
mu në mes të DRENICËS!

Sot o burra të vatanit,
të atdheut e të mejdanit,
sot fundi i luftës ka ardhë,
sot ka gëzim populli shqiptar!

Jemi mbledh në mes Drenicës,
në këtë vatër të Azem Galicës,
në këtë trull të legjendarit,
trim mbi trima ADEM JASHARIT!

Jemi mbledhur me bisedu,
se jem shtet gjithëve me ju tregu,
e lavdi dëshmorëve me ju dërgu,
Nënë KOSOVËS ME JA URU!

Gëzuar festa e PAVARËSISË,
pleqëris e rinisë,
edhe juve o mërgimtar,
kështu feston populli shqiptar!

Lavdi për juve o dëshmor,
ju e mbrojtët nderin tonë,
sot këtë emër mban kjo shoqatë,
PAVARËSI qofsh me jetë të gjatë!

17 SHKURTI (Nr. 3)

Sa lot u derdhen, e sa fëmijë u vran,
sa lule bojëkuqe mbi varre u than,
sa nëna te gjora djemt i varrosën,
sa keq Kosovën e vran e plagosën!

Sa gjaku u derdh e si lumi shkoi,
sa vuajtje e pikllime Kosovën e kaploi,
asnjë kosovar nuk ishte i lumtur,
kur e pa Kosovën si lulen e k'putur!

Kur na dogji malli,
një dritë dielli doli,
titulin e Republikës,
Kosovës ja dhuroi!

17 -SHKURTI,
u shkrua në guri,
u bë themel i shtetit,
themel i një flamuri!

Amaneti i yt,
o BAC U KRY,
tash edhe Kosova,
u bë SHQIPTARI!

Fjalët që i that ende i kujtojmë,

gjaku që u derdhë në kurrë se harrojm,
me një plis të bardhë prin KASTRIOTI,
me dëshmorët e kombit nuk i ndalet loti!

Amanetin tonë,
dheu nuk e tretë,
thotë MEHMETALI BEHLULI,
vdekja jonë është JETË...

17shkurti (Nr. 2)

Mbi shpatullat e shkëmbit të coptuar
jetoni në mërgim me shpirt të lënduar
jeni mbledhur këtu për të festuar
lum për ju, o mërgimtar
mir se na keni ardhë!!!

Veç në ty, e veç për ju
me lidhin endrrat e kujtimet
ti lule e bardhë me lot në sy
o shtrenjta vendlindja ime

17shkurti shoqate kenar
lulekuqja e krenarise shqiptare
me mërgimtarët tanë solidar

Netet që kalojnë për ne
janë të gjata për kë të dhe
shum gëzohemi kur vim tek ti
o sa shumë ndjejm dashuri

Ju mërgimtar, Mireshe e Petrit
17shkurti po ju pret...
po ju pret me krenari
se ju na ndertuat Pavaresinë
o sa gëzim ndjejm për ty

O gëzim e lumturi,
që po ndertoni nga një shtëpi
dhe skamnoreve ndihme po ju dërgoni
me mesazhin e juaj, ju po shkruani
vendin e juaj ta ndertoni dhe ta përparoni

Ju Mireshe e Petrit
ju tani jeni bërë dritë
keni drit shumë mërgimtar
veprat tuaja bënë miresë
për varferi e skamni
fal drejtsis solidarë
që ju të gëzoni këta qytetar
se kështu sofra juve ju do
dhe fëmijet jetim shumë i gëzon

KOSOVE drit e këngë krenare
lavdi qofshin mërgimtarët
këtë shtëpi që e kanë ndertuar
edhe zotin e keni gëzuar

Veprat e mira kurrë nuk vdesin
me mërgimtarët gjithmonë do të mbesin

ne Kosoven ton shiptare
te flasim per ty KOSOVE eshte pune e rende
por na thote
te punojm, ndertojm, vazhdojm

Kthehuni vendlindja ju pret
si foleja zogjet shegetar
kthehuni te gjithë
kudo qe jeni mergimtar
ju presin nenat
tek pragu i shtepis
askund ska vend me te mir
sa toka e ARBERISE

Nje jet e tere ne perendim
bie e zgjohem ne vendin tim
jetojm si zogj shtegetar
gjithmon shqiptar
te ketill gjithmon do mbesim
shqiptar kemi lindur
shqiptar do vdesim

Se keshtu shqiptari e ka zakon
ne rruge jetimat mos me i lan
keshtu t'vazhdojm me vepra t'mira
keshtu na don nenlokja jone
rroft KOSOVA E SHQIPERIA
me 17shkurtin solidar

Shoqata 17shkurti.ch (Nr. 1)

Mire se keni ardhë, ju lutem pak durim!
Dua tua lexoj një poem per fshatin tim.
E shkrova vet askush sme ndihmoj
e pash te rruges dua ta lexoj.
Nuk është kampanjë, as tubim partiak
s'dua te flas per vota, s'dua te flas per parti
e shkrova ket poem per do burra, pleq e të ri
nuk i njoh te gjith, por e di jan te fshatit tim.
U tubuan zbashku atje ne perendim
nuk u tubuan per emer, nuk u tubuan per fitim
deshen ti ndihmojn fshatit, ky ishte i vetmi qellim
Shoqaten 17shkurti ata kan formu, fshatit vet me i ndihmu
Dalipi, Sabiti, Bebi, Rabiti, Agroni, Jetoni, Miftari, Namoni,
Haliti, Ridvani, Njazia, Dardani, Nexhmedini, Jakupi,
Luli, Burhani, Avnija, Naimi, Samia, Enveri, Danushi, Skenderi,
një musafir nderi shum i rrespektuar Arsim Hyseni per ket tubim i ftuar,
Qenani, Hamdija, Hyseni, Alushi, Enveri,
edhe shum te tjer qe ne këtë tekst nuk i kam permbledh.
Të gjith këta e lan veten keq, vetem e vetem qe fshatit ti bëjnë nderë
Deshen qe fshati ynë te jetë shembull për të tjerë
Sepse askush ketu asgje nuk ka sjell
jo qe ne nuk deshëm, por skishim prioritet
shkuan projektet diku ne pushtet
punet e veta ata me i rregull
por ne kemi forc vet mundemi me punu.
Keta te sipershkruarit ashtu te bashkuar
nje projekt madhor zbashku kan realizuar
nje shtepi komplet nje familje ja dhuruan
femijet bonjak shum i gezuan

per ta eshte nje fest por edhe per te gjith ne
kemi diasporen ne ta mundemi me ba BE.
As ata skan teper, as ata si fitojn leht
por kete ata e ben te gjithen me vullnet!
Eshte nje thenje ne librin fetar
ti ndihmosh dikujt eshte pune e mbarë.
Askujt nuk mundesh ndoshta mjaft me i ndihmu
por spaku skamjen dikujt me ja letu
Andaj te gjith ju te pranishem qe jeni ketu
ju lutemi ne kembë me u qu
tua bejmë nje nder dhe ti rrespektojm
ketyre burrave qe per ket fshat po punojn